



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

SYLLABUS i Lëndës Gjuha Gjermane

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Departamenti:	Menaxhim Biznesi
Titulli i lëndës:	Gjuha gjermane
Niveli:	BSc.
Status i lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	III (semestri V)
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	FB
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Lënda synon zhvillimin e shkathtësive komunikative dhe sociale të nevojshme për komunikim në një gjuhë: të shkruarit, të lexuarit, të folurit dhe të dëgjuarit; përvetësimin e njohurive për strukturën e gjuhës; sensibilizimin për aspektet ndërkulturore. Ushtrohen strategji të ndryshme të të lexuarit (global, selektiv e të detajuar), fjalori zgjerohet me shprehje më komplekse të nivelit B 2. Gjatë ligjëratave trajtohen struktura gramatikore në nivelin B 2; ushtrohen shkathtësitë produktive (tiparet e llojeve të ndryshme të teksteve, të folurit) dhe ato receptive. Të katër shkathtësitë do të ushtrohen përmes trajtimit të temave ndryshme. Njëkohësisht bëhet pasurimi i fjalorit të studentëve me fjalë e konstrukte fjalish që përdoren gjatë komunikimit. Për zhvillimin e mësimi do të përdoren krahas teksteve nga libri bazë edhe tekste autentike që ndërlidhen me përditshmërinë, gramatikën e gjuhës gjermane për të huaj, CD-të për ushtrimin e shkathtësisë së të dëgjuarit, etj.
Qëllimet e lëndës:	Në këtë kurs synohet - zhvillimi i shkathtësive receptive dhe produktive të studentit në nivelin B2 të Kornizës së Përbashkët Evropiane; 2 - t'i mundësohet studentit të bëhet përdorues eficient dhe fleksibil i gjuhës gjermane si për qëllime personale ashtu edhe për ato profesionale; - të ngrisë vetëbesimin e studentëve dhe aftësinë e tyre për të komunikuar me folësit burimorë dhe joburimorë të gjermanishtes; - të zhvillojë shkathtësitë studiuese të studentëve dhe shkathtësitë për mësimin e gjuhës; - t'i aftësojë studentët të kombinojnë gjuhën me shkathtësitë reale jetësore; - të inkurajohet mësimnxënia e

	pavarur.		
Rezultatet e pritura të nxënies:	Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje: - të komunikojnë me folësit burimorë dhe ata joburimorë të gjermanishtes me gojë dhe me shkrim me vetëbesim, saktësi dhe rrjedhshmëri në nivelin B2; - të hartojnë lloje të ndryshme të teksteve; - të përdorin shkathtësitë e tyre ndërpersonale në kontekste të ndryshme; - të përdorin mendimin kritik në situata të ndryshme. - të shkruajë fjali në mënyrë të qartë.		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata, Kolokvium	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	2	2
Detyra shtëpie	1	5	5
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	1	3	3
Koha e studimit vetanak të studentit	1	15	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	5	5
Përgaditja përfundimtare për provim	5	4	20
Totali			125
Vërejtje: 1 ECTS kredi = 25 orë angazhim, p.sh. nëse lënda i ka 5 ECTS kredi studenti duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 125 orë			
Metodologjia e mësimdhënies:	- Ligjerata dhe diskutime lidhur me temen përkatëse; - Punë individuale (prezantimi i temave seminarike; - Puna në grupe.		
Metodat e vlerësimit:	- Studentët i nënshtrohen vlerësimit përgjatë gjithë semestrit; - Provimi përfundimtar mbahet me shkrim, ndërsa vlerësimi i shkathtësisë së të folurit bëhet gjatë orëve të ushtrimeve; - Në vlerësimin përfundimtar përfshihet edhe pjesëmarrja aktive në orën mësimore dhe detyrat e shtëpisë.		
Literatura			
Literatura bazë:	1. Koithan U., Schmitz H., Sieber T., Sonntag R., Lösche R.		

	(2008). Aspekte. Lehrbuch 2. Berlin u.a.: Langenscheidt 2. Koithan U., Schmitz H., Sieber T., Sonntag R., Lösche R. (2008). Aspekte. Arbeitsbuch 2. Berlin u.a.: Langenscheidt.
Literatura shitesë:	1. Dreyer H., Schmitt R. (2008): Lehr- und Übungsbuch der deutschen Grammatik. München; 2. Helbig G., Buscha J. (2000): Übungsgrammatik. München; 3. Hall K., Schneider B. (2007): Übungsgrammatik für Fortgeschrittene DaF. Ismaning.

Plani i dizajnuar i mësimit:

Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	Njoffimi me kursin, me planin e kursit
Java e dytë:	Lektion 1; Das Verb
Java e tretë:	Lektion 1; Verwendung der drei Vergangenheitstempora
Java e katërt:	Lektion 1; Stellung der Adjektive im Satz und Adjektivdeklinaton
Java e pestë:	Lektion 2; Wortstellung im Haupt- und Nebensatz; Kausalsätze
Java e gjashtë:	Lektion 2; Konzessiv- und Konsekutivsätze
Java e shtatë:	Lektion 2; Graduierung der Adjektive: Komparativ und Superlativ
Java e tetë:	Testi I – pjesa e parë e vlerësimit
Java e nëntë:	Lektion 3; Trennbare und untrennbare Verben
Java e dhjetë:	Lektion 3; Pural der Substantive
Java e njëmbëdhjetë:	Lektion 4; Indirekte Fragesätze, Finalsätze
Java e dymbëdhjetë:	Lektion 4; Verben und Ergänzungen
Java e trembëdhjetë:	Lektion 5; Infinitiv mit oder ohne zu
Java e katërmbëdhjetë:	Lektion 5; Modalverben
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi II – pjesa e dytë e vlerësimit

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- *Për çdo temë mësimore, studentët do të pajisen me materiale të nevojshme në gjuhën angleze*
- *Në fund të çdo ore mësimore, grupet e caktuara të studentëve do të angazhohen me detyrë apo rast studimi lidhur me temën e ligjëruar.*
- *Rezultatet e arritura nga ajo detyrë, grupet e studentëve duhet ti prezantojë dhe t'i diskutojnë ato në orën e ushtrimeve.*
- *Për të fituar të drejtën për të hyrë në teste dhe provim, studenti duhet të jetë i rregullt në mësim.*